

DFF - SPEEEX

Lokacioni:	KOSOVË
ID e Projektit:	56994
Sektori i biznesit	Përpunimi i të dhënave, shërbimet e hostimit dhe shërbimet e ndërlidhura
Lloji i njoftimit:	PRIVAT
Kategoria mjedisore:	B
Data e miratimit:	09 dhjetor 2025
Statusi:	Në disbursim
Data e publikimit në gjuhën angleze:	08 janar 2026
	Në përputhje me paragrafin 2.6 të seksionit III të Politikës për Qasje në Informacion, publikimi i këtij Dokumenti Përmbledhës të Projektit (PSD) është shtyrë në përputhje me paragrafin 1.4.4 të Direktivës për Qasje në Informacion.
	Sipas seksionit 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasje në Informacion: <i>“Për projektet e miratuara nga niveli drejtues i Bankës, kur Bordi i Drejtorëve ka deleguar autoritetin e miratimit, PSD-ja publikohet në fillim të periudhës përkatëse të njoftimit për mos-kundërshtim drejtuar një shteti anëtar të Bankës, në përputhje me nenin 13 (iii) të Marrëveshjes për Themelimin e BERZH-it.”</i>

Përshkrimi i Projektit

Ofrimi i një kredie afatgjatë deri në 13 milionë euro nga BERZH për SPEEEX, për financimin e kostos së blerjes së Bernina Group.

Objektivat e projektit

Objektivi kryesor i këtij projekti është mbështetja e zgjerimit ndërkombëtar të SPEEEX përmes blerjes së Bernina Group, duke krijuar kështu një prani të drejtpërdrejtë operative në Zvicër, tregun e saj kryesor të eksportit. Ky aktivitet i bashkimit dhe blerjes synon diversifikimin e bazës së klientëve të

SPEEEX, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë dhe profitabilitetit përmes krijimit të sinergjive operative ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës. Gjithashtu, projekti synon promovimin e diversitetit dhe përfshirjes brenda kompanisë përmes një Strategjie të re të Burimeve Njerëzore, duke synuar një raport të balancuar gjinor (50/50), gjë që forcon më tej bazën e talentit njerëzor dhe ndikimin social të kompanisë.

Ndikimi i tranzicionit

Nota e Indeksit të Tranzicionit të Energjisë (ETI): 66

Cilësia primare e ndikimit në tranzicion (TI): Integrimi – pasi projekti mbështet zgjerimin e parë të SPEEEX në një zonë të re gjeografike përmes blerjes së Bernina Group.

Cilësia dytësore e ndikimit në tranzicion: Përfshirja e plotë – pasi projekti synon promovimin e diversitetit dhe përfshirjes në burimet njerëzore përmes një Strategjie dhe Plani Veprimi të ri, si dhe arritjen e një raporti gjinor 50/50.

Projekti merr një **vlerësim ETI** prej 66.

Informacione mbi klientin

SPEEEX SHPK

SPEEEX SH.P.K. është një ofrues i shërbimeve të nën-kontraktimit ose eksternalizimit të proceseve të biznesit (BPTO) dhe shërbimeve të teknologjisë së informacionit (IT), i themeluar në Kosovë në vitin 2016, me rreth 1,560 të punësuar aktualisht. Kompania është në pronësi 100% të një ndërmarrësi vendor, z. Fikret Murati. SPEEEX ofron një gamë të gjerë shërbimesh dhe zgjidhjesh, duke përfshirë qendra kontakti, shërbime të burimeve njerëzore dhe shërbime të IT-së, për kompani që operojnë në rajonin DACH (vendet gjermanishtfolëse), me fokus të veçantë në tregun zviceran. Kompania eksporton shumicën dërrmuese të shërbimeve të saj (mbi 90%) në këto tregje.

Përmbledhje e financimit nga BERZH

EUR 13,000,000.00

Kredi prioritarë afatgjatë deri në 13 milionë euro, që do t'i jepet kompanisë nga BERZH, për të financuar blerjen e Bernina Group në Zvicër (12.6 milionë euro) dhe kosto të tjera të lidhura me të (0.4 milionë euro).

Kostoja totale e projektit

EUR 13,000,000.00

Shtueshmëria

Struktura e financimit: BERZH ofron financim që nuk është i disponueshëm në treg nga burime komerciale, me kushte të arsyeshme dhe terma të arsyeshëm. Për shkak të natyrës së biznesit pa asete të konsiderueshme fizike, si dhe karakterit ndërkufitar të transaksionit, bankat vendore nuk kanë qenë në gjendje të ofrojnë financim.

Zbutja e riskut: Aftësia e BERZH-it për të mundësuar përdorimin e mjeteve financiare dhe financimin pa kolateral në formë të pasurive të paluajtshme, i ofron klientit alternativën e vetme të financimit për të realizuar këtë blerje strategjike ndërkufitare, duke shënuar kështu zgjerimin e parë të drejtpërdrejtë ndërkombëtar të kompanisë në Zvicër. Përfshirja e BERZH-it ndihmon në zbutjen e këtyre risqeve dhe mbështet SPEEEX në diversifikimin e bazës së klientëve dhe forcimin e aftësive të saj për rimëkëmbshmëri, përtej varësisë aktuale nga Sunrise.

Përmbledhje mjedisore dhe sociale

Projekti është kategorizuar si i kategorisë B (ESP 2024). Klienti ofron shërbime mbështetëse në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) dhe burimeve njerëzore (HR) në rajonin DACH, me fokus të veçantë në tregun zviceran. Mjetet financiare do të përdoren për blerjen e katër subjekteve zvicerane që operojnë në të njëjtat fusha biznesi. Banka ka një marrëdhënie ekzistuese me klientin. Risqet kryesore mjedisore dhe sociale janë minimale dhe adresohen përmes politikave të kompanisë. Ato lidhen kryesisht me proceset e biznesit të klientit, qasjet e menaxhimit mjedisor dhe social, marrëdhëniet e punës dhe kushtet e punës, mekanizmat e ankesave, zinxhirin e furnizimit, si dhe mekanizmat dhe masat mbrojtëse për sigurinë kibernetike dhe atë të sistemeve të IT-së. Verifikimet e nevojshme mjedisore dhe sociale (ESDD) janë kryer nga Departamenti i Mjedisit dhe Qëndrueshmërisë (ESD) përmes plotësimit të Pyetësorit Korporativ dhe shqyrtimit të politikave të shkruara të klientit që rregullojnë menaxhimin e kompanisë. Shqyrtimi i pyetësorit ka konstatuar nivele të larta përputhshmërie me standardet për sigurinë e të dhënave dhe informacionit, si dhe për menaxhimin e riskut teknologjik, përmes certifikimeve ISO 9001, ISO 27001, ISO 20000-1 dhe ISO 22301, si dhe përmes certifikimit ISO të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMS), shëndetit dhe sigurisë në punë dhe sigurimit të cilësisë. Ky proces është plotësuar me auditime të brendshme në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) dhe Ligjin Federal Zviceran për Mbrojtjen e të Dhënave (FADP). Politikat dhe procedurat e shkruara të klientit që rregullojnë menaxhimin e kompanisë dëshmojnë ekzistencën e mekanizmave të zhvilluar mirë, të audituar rregullisht dhe në zhvillim të vazhdueshëm për menaxhimin e incidenteve, kontrollin kriptografik, burimet njerëzore (rekrutimi, pagat, të drejtat e punës, leja prindërore dhe shkurtimi i stafit), trajnimet (zhvillimi i karrierës, siguria kibernetike, shëndeti dhe siguria në punë, si dhe proceset e integritetit të punonjësve të rinj), auditimet për mbrojtjen e të dhënave, menaxhimin e kontraktorëve, si dhe një politikë të fuqishme për menaxhimin e zinxhirit të furnizimit dhe furnitorëve. Risqet konsiderohen të adresuara në mënyrë të mjaftueshme përmes proceseve ekzistuese të menaxhimit të kompanisë dhe, për rrjedhojë, nuk kërkohet një Plan Veprimi Mjedisor dhe Social (ESAP).

Vlerësimi i Gjellbër

Projekti vlerësohet si i përputhshëm me Marrëveshjen e Parisit, bazuar në aplikimin e qasjes së BERZH-it për përafrimin me Marrëveshjen e Parisit për instrumente të tjera financiare.

Bashkëpunimi teknik dhe financimi me grant

Bashkëpunimi teknik (TC) do të mbështesë SPEEEX në hartimin dhe implementimin e një Strategjie të re të Burimeve Njerëzore, të fokusuar në barazinë gjinore dhe praktikën përfshirëse. Kjo nënkupton edhe përgatitjen e një Plani Veprimi për Barazinë Gjinore dhe zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuëse dhe trajnimeve përkatëse. Kjo nismë, e financuar deri në 70,000 euro nga Fondi i Posaçëm i Aksionarëve apo SSF (me kontribut 20% nga klienti), synon promovimin e mundësive të barabarta, ngushtimin e hendekut gjinor në paga dhe integrimin e parimeve të diversitetit në rekrutim, trajnim dhe zhvillim të karrierës.

Informacionet e kontaktit të kompanisë

Fikret Murati

info@speeex.com

+383 49 491 649

<https://www.speeex.com/>

SPEEEX SH.P.K. Rruga Dritan Hoxha, Prishtinë, Kosovë

Azhurnimi i fundit i Dokumentit Përmbledhës të Projektit

8 janar 2026

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdo gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH.

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.